



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

04NR 610-33733 /2020

Klinë, 24.11.2020

KONTRATA NR. 11-DKA /2020

KOMUNA KLINË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042, nenit 19, Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar, pika 4, kontrata me vlerë minimale, që përfaqësohet nga drejtori i institucionit arsimor, z. Rasim Millaku, në njërën anë;

Dhe

N.SH.T. "BERISHA" (në vazhdim "Furnizuesi"), me adresë - KLINË, NR. BISNESIT 810316069 të cilën e përfaqëson XHevdet Berisha, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

"RENOVIMI I KLASËS – SHMP "FEHMI AGANI", KLINË"

me numër identifikues: 634-20-079-247

Neni 1

Lënda

Lënda e kontratës do të jetë FURNIZIM – "RENOVIMI I KLASËS – SHMP "FEHMI AGANI", KLINË" nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr. rend	Pershkrimi i puneve	njesia	Sasia	Çmimi njes	Total
1	Demolimi i dyshemes se linoleumit se bashku me shtresen e estrihut ne klase, pastrimi ,gerryerja e mbetjeve te sipërfaqes sipas nevojës dorzimi dhe deponimi ne vend te cilin e aprovon punëdhënsi dhe organi mbikqyres.	m2	70.00	2	140.00 €
3	Demolimi i pragjeve te dyerve te veshura me granit,rrafshimi gerryerja dhe pastrimi i tyre pergaditja per shtresen e linoleumit.	cope	2.00	9	18.00 €
4	Furnizimi transporti shtruarja dhe rrafshimi i shtreses nivelizuese estrih 5-7cm.	m2	70.00	4	140.00 €
5	Furnizimi transporti dhe shtruarja e mases rrafshuese per dysheme per nivelimin e sipërfaqeve ku do te montohet linoleumi.	m2	70.00	1	70.00 €
6	Furnizimi me material dhe montimi i linoleumit shiritor me ngjites ,pozicioni perfshine lajsnet kendore materialin si dhe saldimin e fugave dhe pragjeve.	m2	70.00	7	490.00 €
				GJITHSEJ:	998.00 €

1.2. Sipas karakteristikave të dhëna në ofertën financiare të bashkëngjitur në këtë kontratë

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë– 2 DY DITË nga koha e nënshkrimit të kontratës .

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë NE VENDET E CAKTUARA NGA ORGANIZATORI – Klinë

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetët DDP –KLINË.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **998.00 €.**

DDP (të gjitha të përfshira në çmim (dogana, taksa lineare dhe TVSH)

(NËNTËQIND E NËNTËDHJETË E TETË EURO).

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 .Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.Pagesa do te behet siq vijon: **Me të pranuar të Paisjeve me faturë dhe Fletëdorëzim- fletëpranim .**

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paçartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Menagjimin e kontratës në bazë të Nenit 81 të LPP 05/L-068 do ta bëjë

DREJTORI I SHMP "FEHMI AGANI", KLINË - Z. RASIM MILLAKU

Për Furnizuesin N.SH.T. "BERISHA"		Për Autoritetin Kontraktues SHMP "FEHMI AGANI", KLINË	
Emri:	XHEVDET BERISHA	Emri:	RASIM MILLAKU
Pozita:	DEJTOR	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.11.2020	Data:	29.11.2020
Vula:		Vula:	